VENDIM
Nr. 655, datë 22.7.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS "ROBERT SHVARC" E RRUGËS SË KOSOVARËVE, SI DHE RIKUALIFIKIMI URBAN I BLLOKUT NR. 46, TË BASHKISË SË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës "Robert Shvarc" e i Rrugës së Kosovarëve, si dhe rikualifikimi urban i bllokut nr. 46, të Bashkisë së Tiranës, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen, sipas vlerave të mëposhtme:

a) Për ndërtimin e rrugës "Robert Shvarc", me sipërfaqe prej 42 (dyzet e dy) m² "truall", në vlerën 944 706 (nëntëqind e dyzet e katër mijë e shtatëqind e gjashtë) lekë.

b) Për ndërtimin e Rrugës së Kosovarëve, me sipërfaqe prej 1 460 (një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) m² "truall", në vlerën 83 403 960 (tetëdhjetë e tre milionë e katërqind e tre mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë.

c) Për rikualifikimin urban të bllokut nr. 46 të qytetit, me sipërfaqe prej 117 (njëqind e shtatëmbëdhjetë) m² "truall", në vlerën 6 683 742 (gjashtë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e dyzet e dy) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 91 032 408 (nëntëdhjetë e një milionë e tridhjetë e dy mijë e katërqind e tetë) lekësh të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Tiranës.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë (3) tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë e Tiranës të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 1 619 (një mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) m² "truall" për ndërtimin e rrugës "Robert Shvarc", Rrugës së Kosovarëve, si dhe rikualifikimin urban të bllokut nr. 46 të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. Lista e personave dhe pronave që do të shpronësohen për ndërtimin e rrugës së "Kosovarëve", Bashkia Tiranë

Nr	Emri, mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërf. përgj./ m²	Sip. Tr. të prekur / m²	Çmimi truallit/lekë	Vlera në lekë	Konfirmimi i ZVRPP, Tiranë
1	Hedie Hasan Bashaj	8270	6/432	237.3	198	57,126	11,310,948	Konf.shkr.nr.21468/1, dt.02.12.14
2	Bashkpr.Brari, Deliu, Lusha, Baftjari dhe Garunja.	8270	6/289	1180	830	57,126	47,414,580	Konf.shkr.nr.21468/1, dt.02.12.14
3	Pëllumb, Myzafer Shuka	8270	6/287	400	232	57,126	13,253,232	Konf.shkr.nr.21468/1, dt.02.12.14
4	Bashkpronarët Jani	8270	6/176	318,1	200.0	57,126	11,425,200	Konf.shkr.nr.21468/1, dt.02.12.14
	Totali				**1 460**		**83 403 960**	

2. Lista e personave dhe pronave që do të shpronësohen për rikualifikimin urban të bllokut nr.46, Bashkia Tiranë

Nr	Emri, mmbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërf. Përgj./ m²	Sip. Tr. të prekur / m²	Çmimi në lekë	Vlefta në lekë	Konfirmimi i ZVRPP, Tiranë
1	Bashkpronarët Kamza	8350	2/472	117	117	57,126	6,683,742	Konf.shkr.nr.prot.5842/1,dt.03.04.13
	Totali				**117 m²**		**6 683 742**	

3. Lista e personave dhe pronave që do të shpronësohen për efekt të rikonstruksionit të rrugës "Robert Shvac", Bashkia Tiranë

Nr	Emri, mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Truall/m²	Çmimi/ m²	Vlefta në lekë	Konfirmimi i ZVRPP, Tiranë
1	Mustafa Gjata	8260	6/324	30	22493	674,790	Konf.shkr.nr.prot.18812/1, dt.13.12.12
2	Shpresa Dervishi me 2 bashkpr.	8260	6/271	12	22493	269,916	Konf.shkr.nr.prot.18812/1, dt.13.12.12
	Totali			**42**		**944 706**	